



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 72 prot.

Kamëz, më 25.8.2025

V E N D I M

Nr. 63 .Datë 27.8 2025

MBI

**“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KRIJIMIN E EKIPIT SPORTIV TË QYTETIT TË
KAMZËS NGA KLUBI SPORTIV TRIUMPH FOOTBALL ACADEMY”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.59 Datë 21.08.2025 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin” (ndryshuar me ligjin nr. 105, datë 29.7.2020); Urdhrit me nr. 551, datë 15.08.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesës nr. 7011 prot., datë 13.08.2025, ardhur nga Klubi Sportiv “Triumph Football Academy”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të dhënies së pëlqimit për krijimin e Ekipit Sportiv “TK Kamza” në bashkëpunim me Klubin Sportiv “Triumph Football Academy”.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Kamëz për ndjekjen e procedurave dhe firmosjen e aktmarrëveshjes në mbështetje me aktet ligjore në fuqi.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kamëz, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, si dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

